

Vendim nr. 130 datë 15.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 15.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (S) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SABRI HOXHA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 52 akti, datë 18.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1425, datë 16.10.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 00-2023-286, datë 17.02.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 15, pika 1, 16, 17, 18, 20, 23, 25, 29, 31, 33, 42, 116, 121, 122, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 140, pika 2, shkronja “a” dhe pika 3, shkronja “b”, 142, 143, 145, 146 dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Sabri Hoxha, me detyrë ekspert mjeko-ligjor, në datën 11.02.2014 ka paraqitur kallëzim penal kundër shtetasit B.Xh., drejtues i Institutit të Mjekësisë Ligjore (*IML*),

me pretendimin se ushtronte ndaj tij presion të vazhdueshëm për shkak të detyrës. Ai ka pretenduar se në datën 13.01.2014 i është dorëzuar nga sekretarja një kopje e aktit të ekspertimit të datës 17.12.2023, për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të shtetasit G.K., duke iu thënë se për këtë rast do të diskutohet me drejtorin. Në datën 15.01.2014 ai është thirrur nga drejtori dhe në prani të përgjegjësit të administratës dhe sekretares i është komunikuar masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” për mosvënie të saktë të diagnozës, për arsye se konkluzionet në atë akt ekspertimi binin ndesh me konkluzionet e ekspertëve të tjerë.

2. Në lidhje me këtë kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është regjistruar procedimi penal nr. 3081/2014 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP). Pas kryerjes së hetimeve, prokurori, mbështetur në nenin 328/1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP) të kohës, me vendimin e datës 28.09.2015, ka vendosur pushimin e çështjes penale, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

3. Kundër këtij vendimi, bazuar në nenin 329, pika 1, të KPP-së së kohës, kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatë, me pretendimin se nga ana e prokurorisë nuk janë kryer hetime të plota lidhur me çështjen.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 52 akti, datë 18.01.2016, ka vendosur rrëzimin e ankimit kundër vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. 3081/2014. Kundër këtij vendimi, bazuar në nenin 329, pika 3, të KPP-së së kohës, kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 1425, datë 16.10.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke arsyetuar se nga aktet e administruara në fashikullin e kallëzimit penal nr. 3081/2014 rezulton e provuar se prokuroria ka analizuar drejt kallëzimin e shtetasit Sabri Hoxha dhe se konkluzioni i arritur për pushimin e procedimit penal, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale, është rrjedhojë e analizimit të të gjitha fakteve. Prokuroria ka marrë dhe administruar të gjitha provat e nevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjeve të ngritura në kallëzim, provat shkresore, si dhe ka pyetur ekspertët e IML-së, të cilat janë analizuar në raport me pretendimet e kallëzuesit dhe të kallëzuarit. Sipas gjykatës, pretendimet e kallëzuesit, në lidhje me aktet e ekspertimit të kryera ndaj të ndjerit G.K., kanë qenë objekt i shqyrtimit në një procedim tjetër penal dhe organet vendimmarrëse nuk kanë konstatuar asnjë parregullsi nga ato të pretenduara, për rrjedhojë ajo nuk ka kompetencë për të gjykuar mbi këto akte që janë shqyrtuar njëherë. Për sa u përket pretendimeve për pasojat e shkaktuara nga veprimet e paligjshme të të kallëzuarit B.Xh., që kanë

çuar në pushimin nga puna të kallëzuesit, gjykata ka konstatuar se kjo çështje është një konflikt gjyqësor, i cili është për zgjidhje në gjykatën kompetente. Ajo ka konkluduar se nuk konstatohet ndonjë veprim që nuk është kryer nga ana e prokurorit e që nëse do të kryhej mund të arrihej në një konkluzion të ndryshëm. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-286, datë 17.02.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është i plotë, i argumentuar dhe rrjedhë e analizës të të gjithë akteve të pretenduara nga kallëzuesi, si dhe u jep përgjigje pretendimeve të ankimit duke vlerësuar se nga ana e prokurorit janë kryer veprimet e duhura e të domosdoshme hetimore për faktin penal të kallëzuar. Sipas tij, nuk konstatohet ndonjë shkelje ligjore e neneve 328 dhe 329 të KPP-së dhe ndonjë veprim që nuk është kryer nga ana e prokurorit e që nëse do të kryhej mund të arrinte në një konkluzion të ndryshëm nga ai i arritur. Organi i prokurorisë ka mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për të saktësuar faktet objekt akuze dhe mbi bazën e tyre ka arritur në konkluzionin se duhet vendosur pushimi i çështjes penale nr. 3081/2014 për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i KP-së.

7. Me kërkesën e datës 18.04.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të saj.

II

Pretendimet e kërkuetit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

- 8.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi gjykata e apelit e ka njoftuar me fletëthirrjen e datës 14.09.2017 për t'u dëgjuar në seancën e datës 16.10.2017, ora 10:00 dhe në datën 27.09.2017 ka dorëzuar edhe parashtrimet e tij. Megjithatë, gjykata e ka marrë vendimin në dhomën e këshillimit, në kundërshtim me provat dhe faktet, si dhe me të drejtat e tij kushtetuese. Sipas kërkuetit, në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, ai nuk ka pasur mundësi t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve ose personave të tjerë që mund të sqaronin faktet.
- 8.2. Largimi i kërkuetit nga detyra është bërë në bashkëpunim me prokurorin, për shkak të paraqitjes së kallëzimit për shpërdorim detyre ndaj drejtuesit të IML-së. Ata në bashkëpunim kanë zvarritur kohën me qëllim që t'i jepej kohë të kallëzuarit që të falsifikonte dokumentet zyrtare. I kallëzuarit B.Xh. ka dhënë

deklarim para prokurorit duke mashtruar. Edhe pse ka pasur prova dhe fakte që në ushtrimin e detyrës të tij si drejtor i IML-së ka dhënë urdhëresa me shkrim dhe me firmë për falsifikimin e dokumenteve zyrtare, para prokurorit ai ka deklaruar të kundërtën, çka sipas ligjit përbën deklarim të rremë, që është veprë penale. Gjykatat, në shkelje flagrante të ligjit dhe Kushtetutës, kanë diskriminuar kërkuesin, kanë dhënë vendime pa ligj, në mungesë të tij dhe pa e dëgjuar, duke mbajtur standard të dyfishtë.

- 8.3. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi në vendimet e gjykatave ka mungesë logjike, ato janë të pabazuara në ligj dhe në prova, të paargumentuara dhe qëllimisht bëjnë një analizë të gabuar. Gjykatat kanë anashkaluar provat e paraqitura, duke kryer pastrim të produkteve të veprës penale për të kallëzuarin B.Xh. Gjykatat kanë pasur prova dhe fakte të pakundërshtueshme, si deklarimi i rremë i të kallëzuarit B.Xh., falsifikimi i dokumenteve zyrtare, aktet e ekspertimit, largimi i kërkuesit nga puna pasi ka bërë kallëzim, si dhe fakte të tilla, si kryerja e veprimeve që rëndojnë dhe shtojnë pasojat e veprës penale, kryerja e veprave penale në bashkëpunim, kryerja e veprës penale për të vënë përgjegjësinë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri etj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriterë paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton

mosplotësimi i njërës prej këtyre kritereve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ajo pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës pasi ka shteruar mjetet e ankimit në gjykatat e zakonshme në formë dhe përmbajtje, për rrjedhojë, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, ai nuk ka mjet tjetër juridik efektiv në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 13.01.2023, ndërsa vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i datës 13.09.2022. Për rrjedhojë, ajo është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në mbështetje të pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, kërkuesi ka parashtruar se vendimet e gjykatave kanë mungesë logjike, janë të pabazuara në ligj dhe në prova, të paargumentuara dhe bëjnë një analizë të gabuar qëllimisht. Sipas tij gjykatat kanë anashkaluar provat, duke kryer pastrim të produkteve të veprës penale për të kallëzuarin. Gjykatat kanë pasur prova dhe fakte të pakundërshtueshme, si deklarimi i rremë i të kallëzuarit B.Xh., falsifikimi i dokumenteve zyrtare, aktet e ekspertimit, largimi i kërkuesit nga puna pasi ka bërë kallëzim, si dhe fakte të tilla, si kryerja e veprimeve që rëndojnë dhe shtojnë pasojat e veprës penale, kryerja e veprave penale në bashkëpunim, kryerja e veprës penale për të vënë përgjegjësinë ose për të fshehur përgjegjësinë penale të një tjetri etj.

16. Kolegji vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të këtij pretendimi kanë natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, pasi kanë të bëjnë thelbësisht me çështje të vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme dhe, si të tilla, janë atribut i atyre gjykatave dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur ta ngrejë këtë pretendim në nivel kushtetues.

17. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit, në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar në gjykatën e apelit, Kolegji vëren se ai *prima facie* ka natyrë kushtetuese, për rrjedhojë do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar

18. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit e ka njoftuar me fletëthirrjen e datës 14.09.2017 për t'u dëgjuar në seancën e datës 16.10.2017, ora 10:00, në çështjen për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë dhe në datën 27.09.2017 ka dorëzuar edhe parashtrimet e tij. Megjithatë, gjykata e ka marrë vendimin në dhomën e këshillimit, në kundërshtim me provat dhe faktet, si dhe me të drejtat e tij kushtetuese. Sipas kërkuesit, në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, ai nuk ka pasur mundësi t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve ose personave të tjerë që mund të sqaronin faktet.

19. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Për garantimin e një gjykimi të drejtë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të

pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Secila palë duhet të ketë mundësi të komentojë për të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimet nr. 73, datë 14.12.2015; nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kolegji vëren se ndërsa ankimi i kërkuarit ndodhet në pritje për t'u shqyrtuar në gjykatën e apelit, KPP-ja ka pësuar disa shtesa dhe ndryshime me ligjin nr. 35/2017, përfshirë edhe në Pjesën e Dytë, Titulli VI, Kreu VIII (Përfundimi i hetimeve), nenet 327 e vijues të tij. Sipas këtyre ndryshimeve, veprimtaria e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale i nënshtrohet kontrollit gjyqësor në çdo rast kur procedohet për krime, nëse prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vlerëson se akuza ose çështja duhet pushuar për ndonjë nga rastet e parashikuara nga ligji (neni 328, paragrafi 1, i KPP-së), duke qenë tashmë në kompetencë të gjykatës dhe jo të prokurorit pushimi i akuzës ose çështjes kur procedohet për krime. Nga ana tjetër, kur procedohet për kundërvajtje, prokurorit i ka mbetur kompetenca për të vendosur pushimin e akuzës ose çështjes, ndërsa një vendim i tillë është i ankimeshëm në gjykatë nga subjektet e përcaktuara nga ligji. Në të dyja rastet ligji parashikon të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, ankim i cili shqyrtohet në dhomën e këshillimit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së akteve (neni 329, paragrafi 6, i KPP-së dhe neni 329/b, paragrafi 6 në lidhje me nenin 329, paragrafi 6, të KPP-së).

21. Për rrjedhojë, në funksion të kontrollit rishikues për sa i përket ligjshmërisë në aspektin procedural të vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, të procesit gjyqësor dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për kontrollin e vendimit të prokurorit mbi ankimin e paraqitur, gjykata e apelit mban në konsideratë dispozitat në fuqi në kohën kur janë marrë vendimet e kundërshtuara, kurse për sa i përket procedurës së shqyrtimit në apel, në lidhje me formën e gjykimit (në seancë gjyqësore publike, me dyer të mbyllura ose në dhomën e këshillimit), gjykata e apelit zbaton dispozitat në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, në

respektim të parimit të së drejtës procedurale penale, sipas të cilit ligji i ri ka fuqi edhe ndaj marrëdhënieve procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështje që gjenden në hetim ose gjykim, me përjashtim të rasteve e për një kohë kur vetë ligji shprehimisht ka vendosur ndryshe në dispozitat kalimtare. Në rastin konkret, për këtë aspekt të gjykimit në apel, ligji i ri nuk ka parashikim kalimtar për kohën e veprimit të tij, duke nënkuptuar kështu hyrjen e tij në veprim menjëherë.

22. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi është pala që ka vënë në lëvizje gjykatën e apelit me ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar ankimin e tij ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale. Në ankim ai ka parashtruar të gjitha shkaqet ku e mbështet atë dhe, siç ka pranuar edhe në kërkesë, është njoftuar nga gjykata me fletëthirrje për shqyrtimin e çështjes në datën 16.10.2017, duke depozituar edhe parashtrimet e tij me shkrim para zhvillimit të seancës, pra në datën 27.09.2017. Për rrjedhojë, kërkuesi jo vetëm që ka marrë dijeni efektive për shqyrtimin e çështjes në atë gjykatë, por i është siguruar e drejta që të parashtrojë qëndrimin e tij në atë gjykim. Kurse në lidhje me procedurën e shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit për sa i përket formës së gjykimit, ajo, bazuar në sa më sipër, ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes. Për rrjedhojë, vetëm fakti se çështja e kërkuetit është shqyrtuar në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore, siç pretendon ai, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar dhe e lidhur me të edhe ajo e mbrojtjes.

23. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

24. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.